



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900226/7

Tiranë ___/___/2019

Lënda : Rekomandohet: "*Marrja e masave për plotësimin e detyrimit ligjor sipas nenit 10 pika 6 e ligjit 109/2018, dhe marrjen e vendimit përfundimtar për shpalljen ose jo "Dëshmor i Atdheut" të të ndjerit Ç. N. Xh., nga Blaca e Pogradecit.*

Marrjen e masave dhe organizimin e punës që të zbatohen afatet ligjore të vendimmarrjes".

Drejtuar : Zëvendësministrit të Mbrojtjes
Z. Petro KOÇI

Ministria e Mbrojtjes

TIRANË

I nderuar Z.KOÇI,

Më datë 12.02.2019, shtetasja F. Xh., nga Blaca e Pogradecit i është drejtuar me ankesë Institucionit të Avokatit të Popullit, në të cilën ka ngritur shqetësimin dhe ankohet ndaj Komisionit Qëndror të Statusit "Dëshmor i Atdheut" pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për vonesa të procedurave në marrjen e vendimit përfundimtar për të shpallur djalin e saj, të ndjerin Ç. Xh., "Dëshmor i Atdheut".

Shqetësimi i shtetasës F. Xh., lidhet me ngjarjen e datës 20.08.1992, ku si pasojë e një aksidenti automobilistik kanë humbur jetën djali i saj Ç. Xh., dhe ushtarakë të tjerë. Në momentin e ndodhjes së ngjarjes tragjike, shtetasi Ç. N. Xh., ka qënë duke kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak në repartin ushtarak 3830 Fushë-Arrës.

Mbi këtë shqetësim, më datë 21.02.2019, me shkresën nr. K2/F8-3, i kemi kërkuar informacion Ministrisë së Mbrojtjes, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm, më datë 01.03.2019, me shkresën nr.100 (bashkëlidhur kopje e shkresës) informon Institucionin e Avokatit të Popullit se:

“Propozimi i Prefektit të Korçës, për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, të shtetasit Ç. N. Xh., me plotësimin me dokumente shtesë, të dërguara nga arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe të gjyqësorit, është futur në procedurën administrative të marrjes së vendimit përfundimtar nga Komisioni Qëndror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Komisioni Qëndror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”, me marrjen e vendimit përfundimtar, për shpalljen apo mosshpalljen “Dëshmor i Atdheut” të shtetasit Ç. N. Xh., do të njoftojë zyrtarisht Prefektin e Qarkut Korçë, si institucionin që ka bërë propozimin, si dhe shtetasen F. Xh., me banim në fshatin Blacë të Pogradecit, si personën me kërkesën e së cilës ka filluar procedura e propozimit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga znj. Xh., konstatohet se më datë 12.02.2016, me shkresën nr. 9/1 (bashkëlidhur kopje e shkresës) Prefekti i Qarkut Korçë i është i është drejtuar Këshillit të Ministrave, Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, me propozimin për njohjen e Statusit “Dëshmor i Atdheut” të djalit të saj të ndjerit Ç. Xh.

Prej vitit 2016, shtetasja F. Xh., ka vazhduar përpjekjet e saj duke iu drejtuar me kërkesë Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”. Më datë 24.05.2018, ka marrë një përgjigje nga Drejtorja e Inspektimit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, ku sqarohet ndërmjet të tjerave se: *“Komisioni Qëndror ka shtyrë marrjen e vendimit përfundimtar duke kërkuar nga institucionet arkivore shtetërore, dokumente shtetërore që japin të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e humbje së jetës së shtetasit Ç. N. Xh.”.*

Shtetasja F. Xh., gjithashtu është vënë në dijeni të përgjigjes së Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit më datë 01.03.2019, me shkresën nr.100, por duke parë se nuk ka marrë asnjë njoftim zyrtar nga Komisioni Qëndror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” apo Prefekti i Qarkut Korçë, ku të pasqyrohet zgjidhja e problemit që e shqetëson, më datë 02.05.2019, ka përsëritur kërkesën me të njëjtën përmbajtje, drejtuar Institucionit tonë.

Në nenin 138 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, bëhet fjalë për ankimin ndaj mosveprimit administrativ, të cilin znj. Xh., e ka ezauruar duke paraqitur disa kërkesa pranë Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”. Nga ana tjetër, konstatohet se organi epror nuk ka respektuar detyrimin e tij ligjor të parashikuar në këtë nen, ku thuhet:1. *“Ankimi ndaj mosveprimit administrativ shqyrtohet nga organi epror. Organi epror i kërkon menjëherë organit kompetent, që pa vonesë të paraqesë dosjen e çështjes dhe një raport me shkrim mbi arsyet e heshtjes administrative.3.Organi epror vendos mbi kërkesën në bazë të dosjes së çështjes apo, nëse është e nevojshme, zhvillon hetime administrative shtesë, apo urdhëron organin kompetent që të zhvillojë këto hetime shtesë dhe ta njoftojë për rezultatet e hetimit.4. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, organi epror zgjidh çështjen duke nxjerrë një akt përfundimtar”.*

Në pikën 6 të nenit 10 të Ligjit nr.109/2018 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut” thuhet: *“Propozimet e dërguara nga këshillat e qarqeve, këshillat bashkiakë apo prefektët shqyrtohen nga Komisioni Qëndror, brënda 3 muajve, nga afati i rregjistrimit në sekretarinë e Komisionit Qëndror”.*

Ndonëse ka kaluar një periudhë e gjatë kohe, Komisioni Qëndror nuk ka marrë një vendim përfundimtar pas shqyrtimit të procedurave administrative të kryera, për t'i dhënë një përgjigje ankueses znj. F. Xh., për mënyrën e zgjidhjes së ankesës së saj.

Në pikën 2 të nenit 23 të këtij ligji, i cili bën fjalë për Ankimin thuhet: *“Kundër Vendimit të Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe në rastet kur ky komision, nuk shprehet brënda afateve të përcaktuara në pikën 6 të nenit 10, të këtij ligji, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë gjykatës kompetente, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

Vonesat në ndjekjen e procedurave administrative dhe mosmarrja e një vendimi përfundimtar për zgjidhjen e ankesës së qytetares kanë cënuar të drejtën e saj për të ndjekur dhe rrugën gjyqësore të ankimit ndaj Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, si përsa i përket mbarimit të afatit ligjor për shqyrtimin e ankesës apo në rastin e refuzimit të saj. Mosrespektimi i këtyre detyrimeve ligjore përbën cënim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga këndvështrimi i parimeve kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor që burojnë nga nenet 42 dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenit 6 të KEDNJ, çdo qytetar nuk mund të presë pa kufi për të realizuar të drejtën e tij duke pritur vendimin përfundimtar pas shqyrtimit administrativ të çështjes ashtu dhe kur i është drejtuar gjykatës kompetente dhe ajo ka zvarritur çështjen në mënyrë të pajustificuar.

Shprehim mendimin se periudha e gjatë prej mbi tre vitesh, ka qënë një kohë tepër e mjaftueshme për të kryer veprimet e nevojshme dhe administruar dokumentet eventuale, me qëllim për të dalë me një vendim përfundimtar, për zgjidhjen e kërkesës së shtetases F. Xh.

Prandaj do të sugjeronim që rasti i ankesës së shtetases F. Xh., duhet të bëhet objekt i një analize, për të reflektuar në nxjerrjen e shkaqeve dhe arsyeve të zvarritjes së procedurave të shqyrtimit të saj, parë dhe në kuadër të problematikave të tjera të kësaj natyre, me qëllimin e mirë për një zgjidhje korrekte, efikase dhe brënda afateve ligjore të përcaktuara.

Sa më sipër dhe duke gjetur se ankesa e shtetases F. Xh., është e drejtë, bazuar në nenin 63/3 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë *“Avokati i Popullit ka të drejtët e bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe njeriut nga administrate publike” dhe nenit 21 gërma “b” e ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku thuhet: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:*

b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;

REKOMANDOHET

“Marrja e masave për plotësimin e detyrimit ligjor sipas nenit 10 pika 6 e ligjit 109/2018, dhe marrjen e vendimit përfundimtar për shpalljen ose jo “Dëshmor i Atdheut” të të ndjerit Ç. N. Xh., nga Blaca e Pogradecit.

Marrjen e masave dhe organizimin e punës që të zbatohen afatet ligjore të vendimmarrjes”.

Mbi qëndrimin e mbajtur dhe masat e marra që duhet të merrni ndaj këtij rekomandimi, lutemi që, sipas nenit 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të na ktheni përgjigje brënda 30 ditëve nga data e dërgimit të tij.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

K O M I S I O N E R I

Ermonela RUSPI